



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për themelimin e Qendrës përkujtimore për gjenocidin mbi shqiptarët "Bllacë 1999".
2. Propozimi nga pika 1. e këtij vendimi është parashtruar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup dhe Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Trojet e Veta - Prishtinë, duke u gjendur para momentit historik, kur në pranverë të vitit 2019 bëhen 20 vjet nga kriza kosovare e refugjatëve në Republikën e Maqedonisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 291, datë 06.02.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për rritjen e numrit të këshilltarëve në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 226/4, datë 01.02.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arton Berisha, i vazhdohet mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administratës Publike edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Berisha kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 226/4, datë 01.02.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ilir Morina, i vazhdohet mandati i Kryeshefit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës edhe për tre (3) vjet.
2. Z. Morina kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 226/4, datë 01.02.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Beqir Mezelxhiu, i vazhdohet mandati i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Mezelxhiu, kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019-2021.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit koordinon dhe monitoron zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 07/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Fatos Makolli, emërohet Koordinator Nacional Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
 - 2.1. Përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me çështjet kundër terrorizmin dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm;
 - 2.2. Këshillon Kryeministrin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin;
 - 2.3. Koordinon aktivitetet e të gjitha institucioneve relevante në çështjet kundër terrorizmit dhe masave kundër ekstremizmit të dhunshëm;
 - 2.4. Koordinon, monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e dokumenteve strategjike kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
 - 2.5. Pranon raporte informuese nga institucionet relevante, me qëllim të përgatitjes së dokumenteve strategjike analitike lidhur me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm;
 - 2.6. Është përgjegjës dhe pikë kontakti ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë koordinimin e organizimeve, donacioneve dhe projekteve vendore dhe ndërkombëtare;
 - 2.7. Koordinon të gjitha raportimet rreth përgjegjësive dhe obligimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës në nismat rajonale dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjen e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
3. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi ka të drejtë në emërimin e tre (3) këshilltarëve dhe një (1) asistenti për të ndihmuar në zbatimin e termave të referencës.

5. Koordinatorin do të ketë pagën e barasvlershme me pagën e Ministrit.
6. Këshilltarët e Koordinatorit do të kenë pagën e barasvlershme me pagën e këshilltarit të Ministrit.
7. Paga e asistentit të Koordinatorit është e barasvlershme me pagën e asistentëve të Ministrit.
8. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për mbështetjen buxhetore dhe administrative të Koordinatorit Nacional Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmit.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 500,000,00 (pesëqind mijë) euro për realizimin e aktiviteteve të shënimit të 11 - Vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod (232-13100), kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Programi 80500 - Përkrahja e Kulturës, në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve.
3. Obligohet e Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/89

Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 3562, datë 17.10.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 180.000,00 (njëqindetëdhjetë mijë) euro për përkrahjen e realizimit të filmit "Lojë Jete".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi Thesari me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere për produksionin Iliria Film për filmin "Lojë Jete" në xhirollogarinë banka NLB Prishtina: 1700200100115894.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Prokurimin për Qëllime të Mbrojtjes dhe të Sigurisë.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/89
Datë: 12.02.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për Partneritet, Tregti dhe Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/89
Datë: 12.02.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Vendimit Nr. 04/02 të datës 15.09.2017, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit dhe hapjen e procedurave të punësimit për banorët e shpronësuar të fshatit Hade dhe Shipitullë për vendet e punës në mihjet sipërfaqësore dhe prodhimit të energjisë elektrike

1. Formohet Komisioni për hapjen e procedurave të punësimit për banorët e shpronësuar të fshatit Hade dhe Shipitullë në këtë përbërje:
 - 1.1. Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Përfaqësuesi i Komunës së Obiliqit;
 - 1.3. Përfaqësuesi nga KEK;
 - 1.4. Përfaqësuesi i banorëve të fshatit Hade;
 - 1.5. Përfaqësuesi i banorëve të fshatit Shipitullë.
2. Komisioni ka për obligim që të fillojë procedurat për verifikimin dhe propozimin për vendet e punës në mihjet sipërfaqësore dhe prodhimit të energjisë elektrike sipas elaboratit të KEK të dorëzuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.
3. Komisioni obligohet që të përfundojë punën brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Komunës së Obiliqit
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë